



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.08, datë 04.06.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: "HOTEL 3 DHE 4 KATE**  
**MBI TOKË ME 1 KAT NËNTOKË DHE PISHINË", ME VENDNDODHJE NË**  
**BASHKINË VLORË**

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit shoqërisë "Juna Konstruksion" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: "Hotel 3 dhe 4 kate mbi tokë me 1 kat nëntokë dhe pishinë", me vendndodhje në Bashkinë Vlorë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Juna Konstruksion" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI  
EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT  
MIRELA KUMBARO FUXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 05/12/2024